

# E drejta për informim

## Newsletter mujor mbi mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për të Drejtën e Informimit

Newsletter është publikim i Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

### Fokusi i muajit

#### Mënyrat e dhënies së informacionit dhe afati për marrjen e informacionit

Të gjitha kërkesat për informacion trajtohen, si rregull, nëpërmjet konsultimit pa pagesë të informacionit në mjediset e autoritetit publik, nëpërmjet portalit unik qeveritar ealbania.al apo, kur është rasti, nëpërmjet faqes zyrtare të autoritetit publik në internet.

Kërkesat, që lidhen me dokumente të shkruara, trajtohen duke vënë në dispozicion të kërkuarit:

- një kopje të plotë, në format të njëjtë me atë të përdorur nga autoriteti publik, përveç rasteve të veçanta;
- një kopje të plotë të informacionit nëpërmjet postës elektronike, kur informacioni gjendet në një formë të tillë ose mund të konvertohet.

Lidhur me kërkesat që lidhen me forma të tjera, informacioni jepet në mënyrën më të efektshme dhe me koston më të ulët për autoritetin publik. Në çdo rast, vendimi i refuzimit për formën e kërkuar jepet me shkrim dhe i arsyetuar.

Autoriteti publik trajton kërkesën për informim, sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posaçëm parashikon ndryshe.

Kur autoriteti publik që merr kërkesën për informim ia dërgon atë një autoriteti tjetër, ai kthen përgjigje jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e mbërritjes së kërkesës në autoritetin e parë.

Në çdo rast, mostrajtimi i kërkesës për informim brenda afateve të sipërpërmendura do të konsiderohet refuzim.

### Përmbledhje mujore e vendimeve dhe rekomandimeve

**Vendim nr. 20** - Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**Vendim nr. 21** - Bashkia Bulqizë

**Vendim nr. 23** - Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme

**Vendim nr. 24** - Fondi Shqiptar i Zhvillimit

# Vendimmarrja e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP), gjatë muajit prill, ka dhënë 4 vendime në zbatim të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" (LDI) ku të katër vendimet janë vendime urdhërimi për dhënien e informacionit ndërkohë që një prej tyre përfshin edhe sanksion administrativ gjobë.

Me anë të Vendimit nr. 21, datë 09.04.2021, KDIMDP ka pranuar ankesën për refuzim dhënie informacioni ndaj Bashkisë Bulqizë (Autoriteti Publik) ku kërkohej: "Lista e plotë e të punësuarve në Bashkinë Bulqizë dhe institucionet nën varësi të saj apo në ato shoqëri aksionere ku Autoriteti Publik zotëron 100% të kapitalit: emër - mbiemër dhe pozicionin e punës që mban. Lista kërkohej të shoqërohej edhe me emërtimin e organikës ose departamentet përkatëse".

Në ndjekje të procedurave administrative, Zyra e Komisionerit kërkoj nga Autoriteti Publik vlerësimin e dhënies së informacionit. Autoriteti Publik, ktheu përgjigje duke argumentuar se: "Informacioni i kërkuar nuk mund të vihet në dispozicion pasi konsiderohet konfidencial, ndërkohë që vuri në dispozicion Vendimin e Kryetarit të Bashkisë mbi miratimin e strukturës / organikës/kategoritë/nivelin e pagave/klasën e pagave për çdo pozicion të administratës së bashkisë dhe njërive shpenzuese në varësi të Bashkisë Bulqizë për vitin 2021", i cili gjendet edhe në faqen zyrtare të Web-it të bashkisë".

Zyra e Komisionerit vlerësoi se lidhur me argumentin e parashtruar nga ana e Autoritetit Publik, se informacioni i kërkuar, konsiderohet konfidencial, nuk qëndron. Në parim, aksesimi dhe përpunimi i të dhënave personale legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në nenin 6 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Në qëndrimin e Autoritetit Publik u konstatua se kufizimi i aksesit është bërë në referim të VKM-se nr. 117, datë 5.3.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit", pa marrë parasysh dispozitat e

TRANSPARENCA E AUTORITETEVE  
PUBLIKE ËSHTË PARADHOMA  
E MIRËQEVERISJES

VIZITONI WWW.IDP.AL

## #informim #transparencë #vendim

Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Bazuar në shkronjën b) të pikës 4 të nenit 4 të ligjit të sipërcituar, ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave vetëm për rastet kur jepet informacion për persona publik zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre.

Gjithashtu, bazuar në pikën 5, fusha 1, të Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore miratuar me Urdhrin nr. 211, datë 10.9.2018 të Komisionerit, "Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë, në pikën 5, Administrata e bashkisë përfshin bërjen publike të - Drejtuesit e zyrave, njërive administrative dhe njërive të varësisë". Për rrjedhojë, një pjesë e informacionit të kërkuar përfshihet në kategorinë e informacionit që vendoset në dispozicion të publikut pa kërkesë.

Në përfundim të procesit administrativ të shqyrtimit të ankesave KDIMDP vendosi Urdhërimin e Autoritetit Publik për dhënien e informacionit të kërkuar; dënimin e Sekretarit të Përgjithshëm në cilësinë e personit përgjegjës, me gjobë në vlerën 150.000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë, në përputhje me nenin 19, pika 2 dhe 3 e ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit".

Kundër vendimmarrjes në pikat 1, dhe 2, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 45 ditëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me nenin 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit"


Për më shumë informacion mund të lexoni të plotë vendimet në faqen e KDIMDP [www.idp.al](http://www.idp.al).

# Raport monitorimi “Transparenca dhe Llogaridhënia në Nivelin e Qeverisjes Vendore”

Në muajin prill, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim organizoi konferencën për prezantimin e raportit të monitorimit “**Transparenca dhe Llogaridhënia në nivelin e qeverisjes vendore Një vlerësim krahasues i Programeve të Transparencës në 12 bashki të vendit**”.

Qëllimi kryesor i këtij raporti ishte vlerësimi i transparencës proaktive të 12 bashkive qendër qarku (Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër, Durrës, Tiranë, Elbasan, Fier, Berat, Vlorë, Korçë dhe Gjirokastrë), përmes monitorimit të Programeve të Transparencës. Gjetjet dhe rekomandimet e këtij raporti monitorues synojnë të nxisin më tej organet e pushtetit vendor për të rritur nivelin e transparencës përmes publikimit proaktiv të informacionit.

Në Konferencë ishte pjesëmarrëse edhe Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Komisioneri Besnik Dervishi përgëzoi hartuesit e raportit si dhe të gjitha organizatat e shoqërisë civile lokale që punuan drejtëpërdrejtë me monitorimin e programeve të Transparencës së Bashkive pjesë e raportit duke i nxitur më tej në kërkimin dhe hulumtimin e tyre me qëllim rritjen e transparencës së njëjësive të vetëqeverisjes vendore. Gjithashtu Komisioneri i ftoi këto organizata për të punuar ngushtësisht me Zyrën që ai përfaqëson në arritjen e këtij qëllimi të përbashkët. Në këtë aktivitetet morën pjesë edhe përfaqësues të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, shoqërisë civile, medias, akademisë dhe aktorë të tjerë kyç vendorë që punojnë dhe kanë interes në çështjet e transparencës, antikorrupsionit dhe llogaridhënies vendore.



# Legjislacioni për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale në funksion të veprimtarisë së Qendrës Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në bashkëpunim me Qendrën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (CVE) organizuan trajnimin me tematikë “E drejta e informimit dhe mbrojtja e të dhënave personale në raport me çështjet e P/CVE - standardi bazë ligjor dhe rastet e kufizimeve të tyre”.

Në këtë aktivitet ishin të pranishëm stafi i Qendrës dhe pjesëtarë të rrjetit të bashkëpunëtorëve të saj nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ajo e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, institucione zbatuese të Strategjisë Kombëtare për Luftën Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Në takim u trajtua ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe ai nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, roli dhe funksionet monitoruese e mbikëqyrëse të Zyrës së Komisionerit, balanca mes këtyre dy të drejtave apo kur ato kufizohen në raport me objektin e veprimtarisë së CVE, si dhe për raste praktike nga të dy këto fusha. Trajnimin e drejtuan znj. Elona Hoxhaj, Drejtor i Drejtorisë së Vlerësimit të Ankesave në Drejtorinë e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit dhe znj. Pjerina Gaxha, Drejtor i Drejtorisë së Ankesave dhe Harmonizimit në Drejtorinë e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Njohja me liritë dhe të drejtat themelore të njeriut janë në fokus edhe të trajnimeve të ardhshme të Zyrës së Komisionerit dhe CVE për rrjetin e bashkëpunëtorëve të saj.

